

# KADASTRA FISKALE

## BULETIN INFORMUES

Botimi 4

29 MARS 2022

### Statistika Vendore për Taksën e Pasurisë


Grafikët më poshtë reflektojnë performancën mbi mbledhjen aktuale të të ardhurave në nivel vendor. Të dhënat janë gjeneruar nga Sistemi i Thesarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

#### Të ardhurat nga taksa e pasurisë

Taksa e pasurisë po bëhet një burim gjithnjë e më i rëndësishëm të ardhurash për bashkitë në Shqipëri. Në vitin 2021, të ardhurat totale ishin 5.68 miliardë lekë. Rritja e të ardhurave në vitin 2021 ishte 21% krahasuar me një vit më parë. Ky është një zhvillim shumë premtues, duke kontribuar në fuqizimin e bashkive për të ofruar shërbime cilësore për qytetarët e tyre.


Bashkia e Tiranës mbledhi afërsisht 43% të të ardhurave totale. Siç shihet dhe në grafikun e mëposhtëm, duke përfshirë Bashkinë Tiranë, për vitin 2021, të ardhurat nga taksa e pasurisë shënuan një vlerë prej 3.27 miliardë Lekë.

*Grafiku 1: Shpërndarja e të ardhurave nga taksa e pasurisë në vite.*



*Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

Grafiku 2: Ndryshimi në përqindje (%) i të ardhurave nga taksa e pasurisë 2020/2021



Burimi: MFE

## Ndryshimi në % i të ardhurave nga taksa e pasurisë sipas bashkive

Të ardhurat nga taksa e pasurisë kanë patur një trend pozitiv nga viti 2020-2021 në 41 ( nga 61) bashki.

Siç u shpjegua më lart, rritja totale e të ardhurave në nivel kombëtar nga taksa e pasurisë në vitin 2021 ishte 21% krahasuar me vitin 2020. Këtu mund të themi se kjo rritje nuk është e shpërndarë në mënyrë të barabartë midis bashkive: disa patën një rritje të dukshme, ndërsa të tjerat kishin rënie.

Sipas grafikut nr. 2, rritja më e madhe e të ardhurave është regjistruar në bashkinë Mallakstër (+302%), Kuçovë (+239%), Durrës (+80%), Rrogozhinë (+77%) dhe Selenicë (+73%). Analiza më të thelluara mbi këto rezultate do të jenë objekt i buletinëve në vijim.

## Vizita pune të organizuara në bashkitë Vlorë dhe Selenicë

Në kuadër të ndërveprimit të vazhduar me bashkitë, DPTP në bashkëpunim me Projektin ProTax Albania, i financuar nga SIDA/Qeveria Suedeze dhe Projektin “Financat Vendore”, mbështetur nga SECO/Qeveria Zviceriane, me datë 10 - 11 mars zhvilluan një vizitë pune në Bashkitë Vlorë dhe Selenicë. Qëllimi kryesor i vizitave ishte diskutimi mbi statusin aktual të angazhimit të këtyre bashkive në procesin e pilotimit të reformës së taksës së pasurisë dhe prezantimi i versionit më të fundit të Sistemit Informatik të Kadastrës Fiskale.

Objekt i diskutimit ishin edhe parakushtet praktike për mbledhjen e taksës së pasurisë. Në këtë aspekt, parakushtet në Vlorë dhe Selenicë janë të ndryshme, por kanë dhe shumë ngjashmëri. Për shembull, një problem i përbashkët i tyre është mungesa e njohurive të taksapaguesve për taksat vendore në përgjithësi dhe taksën e pasurisë në veçanti. Të dyja bashkitë shohin nevojën e rritjes së ndërgjegjësimit të taksapaguesve.

### Bashkia Vlorë

Bashkia Vlorë ka rekrutuar një strukturë të vecantë e cila do të fokusohet në regjistrimin e të dhënave dhe punën në terren për përditësimin, popullimin dhe konsolidimin me të dhëna të Kadastrës Fiskale.

Në takim, midis stafeve dhe ekspertëve nga dy projektet, u diskutuan gjerësisht çështjet që lidhen me administrimin e taksave vendore në bashki me fokus në taksën e pasurisë. Më konkretisht, diskutimet prekën tematikat mbi rëndësinë e taksës së pasurisë në buxhetin vendor, parashikimet dhe planifikimi i të ardhurave, komunikimi me taksapaguesit, si dhe procese të tjera të lidhura.

Në një rrafsh më praktik, në linjë dhe me fushën e përgjegjësive të strukturës së re të angazhuar në Bashkinë Vlorë, pati një prezantim të detajuar lidhur me:

- Sistemin Informatik të Kadastrës Fiskale
- Punën në terren për regjistrimin e të dhënave

Palët mbeten të angazhuara për të vazhduar me zbatimin e proceseve sipas planit të aktiviteteve në përbushje të objektivit të Bashkisë Vlorë.

*Foto gjatë vizitës në Bashkinë Vlorë*



## Bashkia Selenicë

Pjesë e këtij turi workshopesh në bashki, ishte edhe vizita në Bashkinë Selenicë nga DPTP dhe ekspertët e Projektit ProTax Albania.

Bashkia Selenicë është në vazhdim të zbatimit të proceseve të taksës së pasurisë dhe taksimit sipas Sistemit Informatik të Kadastrës Fiskale. Në këtë kuadër, në këtë takim fokusi ishte mbi trajnimin për versionin e përditësuar të Kadastrës Fiskale, inspektimin në terren nëpërmjet pajisjeve smart (tableta) dhe procesin e regjistrimit dhe rakordimit të pagesave të detyrimeve.

*Foto gjatë vizitës në Bashkinë Selenicë*



Në fund të kësaj vizite dy-ditore morëm më shumë informacion nga situata në këto bashki. Gjatë diskutimeve u dhanë shumë ide të cilat do të merren në konsideratë për zhvillimin e mëtejshëm të Kadastrës Fiskale. DPTP dhe ProTax janë falenderues për njohuritë e shpërndara dhe kontributin e dobishëm të secilit pjesëmarrës në takim.



Reforma e Taksës së Pasurisë kryhet pjesërisht përmes bashkëpunimit midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Suedeze të Taksave. Bashkëpunimi zhvillohet përmes projektit të quajtur ProTax Albania.

Qëllimi i projektit është **fuqizimi i bashkive duke rritur të ardhurat e tyre vetjake**. Projekti synon administrim modern dhe uniform të taksës së ndërtesës, ku taksimi do të bazohet në vlerën e tregut. Një sistem i qendëruar IT, cilësi e përmirësuar e regjistrave dhe taksapagues të mirë informuar, së bashku me një kuadër ligjor modern pritet ta bëjnë taksimin më të drejtë dhe efikas.

ProTax Albania financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim.



**Ministria e Financave dhe  
Ekonomisë**  
**Bulevardi Dëshmorët e Kombit  
Nr.3, Tiranë**



**Alvaro.Bulku@financa.gov.al**  
**Klaudia.Vukzaj@financa.gov.al**  
**Valmira.Fejza@financa.gov.al**  
**Eva.Hasa@financa.gov.al**



**<https://dptp.financa.gov.al>**